



Përfaqësimi i të rinjve në listat e kandidatëve për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 25 prill 2021



-ANALIZË -

Edhe pse të rinjtë përbëjnë 1/3 e popullsisë me të drejtë vote shpesh përfshihen në mënyrë disproporcionale në organet politike që përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Qëndresa Qytetare, në kuadër të nismës së ndërmarrë për të monitoruar pjesëmarrjen e të rinjve në zgjedhje, mbështetur nga Westminster Foundation for Democracy ka analizuar përfaqësimin e të rinjve në listat e kandidatëve për deputetë të 3 partive kryesore në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 Prill 2021.



QENDRESA
QYTETARE




WFD

Funded by
UK Government

Ky botim u përgatit përmes projektit "Zgjedhje Gjithëpërfshirëse" të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet dhe përmbajtja e tij janë të autorit.

PËRFAQËSIMI I TË RINJVE NË LISTAT ZGJEDHORE

Në analizë është marrë për qindja e kandidatëve pjesëmarrës në lista, gjinia e tyre, potenciali për tu zgjedhur si parlamentarë të ardhshëm dhe mosha mesatare e tyre. Gjithashtu për të matur ecurinë ndër vite të përfaqësimit të të rinjve në zgjedhje, është bërë edhe krahasimi me pjesëmarrjen e të rinjve në lista në zgjedhjet qendrore të vitit 2017.



Mosha maksimale e përlogaritur në këtë analizë për konsiderimin e kandidatëve të rinj është **18 deri në 29 vjeç**, referuar kufirit moshor të rinisë të parashikuar në ligjin 75/2019 Për Rininë, standarteve të Bashkimit Europian për moshën e të rinjve dhe kriterëve studimore që përdor INSTAT në vendin tonë. Për secilën nga 3 partitë kryesore në vend janë marrë në analizë kandidatët e rinj në nivel kombëtar dhe në nivel qarku apo zone zgjedhore duke evidentuar për qindjet e pjesëmarrjes së tyre dhe kandidatët potencialë për t'u bërë pjesë e parlamentit pas zgjedhjeve të

25 Prillit. Nisur nga tendenca e partive politike në vite për të vendosur në fund të listave kandidatët e rinj, Qëndresa Qytetare ka konsideruar **kandidat të ri (deri në 29 vjeç) potencial** për të qënë pjesë e parlamentit të ardhshëm, çdo kandidat që bën pjesë në listën fituese, referuar rezultateve të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017.



Numri i kandidatëve të rinj në listat për deputetë në zgjedhjet e 25 Prillit është 54, 50 kandidatë më pak se numri i kandidatëve të rinj që garonin në zgjedhjet e vitit 2017.

Lidhur me pjesëmarrjen gjinore të të rinjve në listat e 3 partive politike kryesore në vitin 2021 garojnë më shumë candidate vajza (35) se djem (19) ndërsa në vitin 2017 garonin 41 vajza dhe 63 djem. Moshja mesatare e kandidatëve të rinj të 3 forcave politike në zgjedhjet e vitit 2021 është 26 vjeç, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2017, kjo mesatare ishte 25 vjeç, pra kemi një rritje të lehtë të mesatares së moshës rinore të kandidatëve për deputetë.

Të rinjtë në listat e kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste

QARKU	NR I KANDIDATËVE TË RINJ 2017	% në 2017		% në 2021	NR I KANDIDATËVE TË RINJ 2021
Tiranë	4/37	10.8%	↑	11%	4/36
Durrës	0/16	0%	↑	6.6%	1/15
Shkodër	0/11	0%	↑	16.6%	2/12
Korçë	1/13	7.7%	↑	8.3%	1/12
Fier	2/16	12.5%	↓	5.5%	1/18
Elbasan	2/20	10%	↓	6.6%	1/15
Kukës	0/3	0%	●	0%	0/3
Berat	1/8	12.5%	↓	11.1%	1/9
Gjirokastrë	0/4	0%	↑	16.6%	1/6
Dibër	0/6	0%	●	0%	0/6
Lezhe	3/8	37.5%	↑	33.3%	3/9
Vlorë	1/14	7.1%	↓	0%	0/12
Nr Total	14/156	8.9%	↑	9.8%	15/153

Partia Socialiste e Shqipërisë ka dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një listë me 153 kandidatë për deputetë në zgjedhjet e 25 prillit për Kuvendin e Shqipërisë. 15 nga 153 kandidatët i përkasin grupmoshës rinore 18 – 29 vjeç të cilët përbëjnë rreth 9.8% të totalit të personave që garojnë në zgjedhjet e 25 prillit. Partia Socialiste krahasuar me vitin 2017 ka një rritje

me 1 kandidat të ri më shumë në listë, por ka një rënie sa i takon kandidatëve potencialë për të qënë deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, ku nga një që kishte në vitin 2017, në vitin 2021 nuk ka asnjë kandidat

potencial, pra më shumë gjasa në ulëset e kuvendit që do të fitohen nga Partia Socialiste nuk do të ketë asnjë kandidat të moshës 18 – 29 vjeç.

Partia Socialiste në 5 nga 12 zonat zgjedhore nuk ka kandiduar asnjë të ri në listën e depozituar pranë KQZ, ndërsa zona zgjedhore me më shumë kandidatë të rinj është qarku Lezhë me plot 33.3% apo 3 nga 9 kandidatët janë të rinj.

Mosha mesatare e kandidatëve të rinj në Partinë Socialiste për zgjedhjet e vitit 2021 është 28 vjeç, një vit më e lartë se mosha mesatare e kandidatëve të kësaj partie në vitin 2017. Ndërsa sa i përket gjinisë, 9 nga 15 kandidatët e rinj janë vajza dhe 6 kandidatë djem. Ky është një tregues i pandryshuar nëse i referohemi edhe gjinisë së kandidatëve të rinj në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017.

Të rinjtë në listat e kandidatëve për deputetë të Partisë Demokratike

QARKU	NR I KANDIDATËVE TË RINJ 2017	% në 2017		% në 2021	NR I KANDIDATËVE TË RINJ 2021
Tiranë	10/50	20%	↓	0%	0/36
Durrës	3/19	15.7%	↓	6%	1/15
Shkodër	5/18	27.7%	↓	8.3%	1/12
Korçë	7/15	46%	↓	0%	0/12
Fier	6/21	28.5%	↓	5.5%	1/18
Elbasan	2/20	10%	↓	0%	0/15
Kukës	0/3	0%	●	0%	0/3
Berat	0/8	0%	●	0%	0/9
Gjirokastrë	2/4	50%	↓	0%	0/6
Dibër	4/9	44.5%	↓	0%	0/6
Lezhe	2/9	22%	↓	11%	1/9
Vlorë	2/13	15%	↓	8.3%	1/12
Numri total	43/189	22.7%	↓	3.2%	5/153

Partia Demokratike e Shqipërisë ka dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një listë me 153 kandidatë për deputetë në zgjedhjet e 25 prillit për Kuvendin e Shqipërisë.

5 nga 153 kandidatët i përkasin grupmoshës rinore 18 – 29 vjeç

të cilët përbëjnë vetëm 3.2% të totalit të personave që garojnë në zgjedhjet e 25 prillit për këtë forcë politike. Partia Demokratike krahasuar me vitin 2017 ka një rënie të lartë me 38 kandidatë të rinj më pak në listë. PD ka vetëm 1 kandidate potenciale për të qënë deputete në Kuvendin e Shqipërisë e cila garon në qarkun e Durrësit e 6 në listë, ndërkohë që në zgjedhjet e vitit 2017, kjo parti kishte 5 kandidatë të rinj potencialë për deputetë.



3 nga 5 kandidatët e rinj të listës së Partisë Demokratike i përkasin partive aleate të koalicionit “Aleanca për Ndryshim”, përfshi edhe kandidaten e vetme potenciale për të qënë deputete në kuvendin e ardhshëm e cila vjen nga Partia Lëvizja e Legalitetit.

Partia Demokratike në 7 nga 12 zonat zgjedhore nuk ka kandiduar asnjë të ri në listën e depozituar pranë KQZ.

Mosha mesatare e kandidatëve të rinj në Partinë Demokratike për zgjedhjet e vitit 2021 është 26 vjeç, një vit më e ulët se mosha mesatare e kandidatëve të kësaj partie në vitin 2017. Ndërsa sa i përket gjinisë, 3 nga 5 kandidatët e rinj janë vajza. Ky është një tregues i përmirësuar nëse i referohemi edhe gjinisë së kandidatëve të rinj në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017.

Të rinjtë në listat e kandidatëve për deputetë të Lëvizjes Socialiste për Integrim

Lëvizja Socialiste për Integrim ka dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një listë me 153 kandidatë për deputetë në zgjedhjet e 25 prillit për Kuvendin e Shqipërisë. 34 nga 153 kandidatët i përkasin grupmohës rinore 18 – 29 vjeç të cilët përbëjnë rreth 22.2 % të totalit të personave që garojnë në zgjedhjet e 25 prillit. LSI krahasuar me vitin 2017 ka një rënie me

13 kandidatë të rinj më pak në lista por është partia me më shumë kandidatë të rinj ndër forcat kryesore politike. LSI gjithashtu në zgjedhjet e 25 Prillit ka në garë 3 kandidatë të rinj potencialë për tu ulur në Kuvendin e Shqipërisë pas zgjedhjeve, të njëjtin numër që kishte edhe në zgjedhjet e vitit 2017.

Lëvizja Socialiste për Integrim vetëm në 2 nga 12 zonat zgjedhore nuk ka kandiduar asnjë

QARKU	NR. I KANDIDATËVE TË RINJ 2017	% në 2017		% në 2021	NR. I KANDIDATËVE TË RINJ 2021
Tiranë	21/36	58.3%	↓	22.2%	8/36
Durrës	5/14	35.7%	↓	0%	0/15
Shkodër	3/11	27.3%	↓	25%	3/12
Korçë	2/12	16.6%	↑	33.3%	4/12
Fier	3/16	18.8%	↑	44.4%	8/18
Elbasan	3/14	21.4%	↓	20%	3/15
Kukës	0/3	0%	↑	66.6%	2/3
Berat	4/8	50%	↓	11.1%	1/9
Gjirokastrë	0/4	0%	●	0%	0/6
Dibër	1/6	16.6%	●	16.6%	1/6
Lezhe	2/8	25%	↓	22.2%	2/9
Vlorë	3/13	23.1%	↓	16.6%	2/12
Nr. Total	47/145	32.4%	↓	22.2%	34/153

të ri në listën e depozituar pranë KQZ, ndërsa zona zgjedhore me më shumë kandidatë të rinj është qarku Korçë me plot 4 nga 9 kandidatët të rinj.

Mosha mesatare e kandidatëve të rinj në Partinë Socialiste për zgjedhjet e vitit 2021 është 26 vjeç, një vit më e lartë se mosha mesatare e kandidatëve të kësaj partie në vitin 2017. Ndërsa sa i përket gjinisë, 21 nga 34 kandidatët e rinj janë vajza dhe 13 kandidatë djem. Ky është një tregues i pandryshuar nëse i referohemi edhe gjinisë së kandidatëve të rinj në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017.

Gjetjet kryesore


- Krahësuar me zgjedhjet e vitit 2017, numri i kandidatëve të rinj në listat e 3 partive politike kryesore në vend është reduktuar nga 104 në 54 kandidatë të rinj.



- Partia me më shumë kandidatë të rinj në zgjedhjet e 25 prillit është LSI (22.2%) ndërsa forca politike me më pak kandidatë të rinj është Partia Demokratike (3.2%).



- Partia Socialiste pritet të mos ketë asnjë kandidat të ri potencial për t'u bërë pjesë e Parlamentit pas zgjedhjeve të 25 Prillit. PD ka vetëm një kandidate të re potenciale dhe LSI ka 3 kandidatë të mundshëm për të fituar ulëse në kuvendin e ardhshëm.



- Qarqet me numër të kufizuar mandatesh kanë më pak të rinj në lista se zonat e mëdha zgjedhore, tregues i mosbesimit të partive në drejtim të politikanëve të rinj.



- Në listat e 3 partive politike kryesore në vitin 2021 garojnë më shumë kandidate vajza (35) se djem (19), ndërsa mosha mesatare e kandidatëve të rinj është 26 vjeç.



